




REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA /
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA

01 Nr./Br. 400105-19348
Data/Datum 01.08.2022

Gjakovë-Djakovica-Gjakova

~~Kuvendi i Komunës - Gjakovë~~

01 Nr. /2022

Dt. 28.07.2022

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12. të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në Rregulloren Nr. 04/2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, dhe nenit 15 pika 1 të Rregullores 01 nr. 110/01-3560/2020 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës, të datës 30.01.2020, në mbledhjen e mbajtur me dt.28.07.2022, pas diskutimeve lidhur më pikën e 5 të rendit të ditës: Shqyrtimi i Propozim Vendimit për ndarjen e Subvencioneve në vlerë 35.000€ KFC “Vëllaznimi“, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Propozim-Vendimi i Kryetarit të Komunës për ndarjen e subvencioneve në vlerë prej 35,000,€ për Klubin e Futbollit KFC “Vëllaznimi” nga Gjakova .
2. Mjetet financiare të cekura në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve gjatë realizimit të veprimtarisë Sportive të KFC “Vëllaznimi” në Gjakovë .
3. Shuma e mjeteve financiare sipas pikës 1 të këtij vendimi do të ndahen nga Kategoria Subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, e Komunës së Gjakovës .
4. Obligohen Organet e Administratës Komunale për kryerjen e të gjitha procedurave në harmoni me të gjitha aktet Ligjore dhe nënligjore në fuqi, për ekzekutimin e mjeteve Financiare sipas pikës 1 të këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
6. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini .
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
 - Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
 - Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
 - Klubit të Futbollit KFC “ Vëllaznimi” .
 - Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës
 - Arkivit

